

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Exchange tomson” SH.P.K

HYRJE

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**Exchange tomson**” SH.P.K themelohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të parashikuara në Ligjin Nr 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën Kombëtare të Biznesit”.

KREU I
PJESA E PËRGJITHSHME
NENI 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 07.11.2023, Une themeluesi, kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “Exchange tomson” SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

- **Tom Shqalshi**, lindur në Malaj, më 15.04.1968, shtetas Shqiptar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. ID G80415338G, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 2

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

- Transferta parash në emer dhe për llogari të një institucioni tjetër jo Banke.
- Këmbim Valutor
- Agjensi udhëtimi (shitje e biletave të avionit, tragetit, trenit, paketa udhëtimi, dhënie automjete me qira, etj)
- Sigurime biznesi, jete, automjete
- Tregëtim i artikujve kancelarik, fotokopje, printime
- Tregëtim i artikujve të ndryshëm (veshmbathje, industrial, ushqimor)

- Imobiliare (shitblerje e dhenie me qira apartamente banimi, lokale, etj)
- Administrim ambjentesh te bashkepronesise ne ndertesat e banimit
- Pastrim gjelberim, pastrim te fasadave me xham
- Projektme urbanistike
- Kurse per arsim parauniversitar, arsim baze – cikel i ulet
- Lojra elektronike per femije e te rritur (playstation)
- Ekspertize ekonomike financiare
- Veprimtari e agjentit per tranferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jo Banke. Te gjitha sherbimet e pagesave dhe te tranferimit te parave ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jo Banke. Veprimtari e agjentit komisioner. Sherbimet Union Net - Wester Union.

NENI 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon që prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4

Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: *Rruga Konferenca e Pezes, Lagjja nr 12, perball Spitalit Amerikan 3, ndertese 1 kateshe, Njesia Administrative nr 6, Tirane*
2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është *tomshqalshi68@gmail.com*
3. Shoqëria ka te drejtë të hap degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **2 500 000** (dy milion e peseqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Tom Shqalshi**, kontribuon me 1 (nje) kuote prej 2 500 000 (dy milion e peseqind mije) Lekë, ose zoterues i 100 % (njeqind perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas rregjistrimit te Shoqerise ne rregjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise.

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asambleja e Ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta respektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese.

NENI 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) Shitblerjes (me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) Trashëgimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjetër të parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përse nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithëshme e ortakëve është përgjegjësi për marjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve
- ç) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) percaktimin e shpërblimeve për personat e përmëndur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, perfshinë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- k) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve të asamblesë
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortakët mund të përfaqesohen në asamblenë e përgjithëshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithëshme.

Autorizimi mund të jepet vetem për një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose me mesazh elektronik duhet të përmbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij NENI, ajo mund të marr vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marr vendime, pavarsishtë parregullsisë.

NENI 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkon një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotëojnë më shumë se 51 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas NENI-t 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetem, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nënit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera:

- a) përcakimi i politikave tregtare të shoqërisë
 - b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve
 - c) emerimin e shkarkimin i likujduesve dhe të ekspertëve kontabël
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshin përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
 - e) përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 12

Përgjashtëmi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimin për:
 - a) vleresimin e veprimtarisë së tij
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
 - c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejte ripërtëritje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Aministrator i shoqërisë emërohet **Z. Tom Shqalshi**, lindur ne Malaj, me 15.04.1968, shtetas Shqiptar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. ID G80415338G, madhor me zotësi të plotë juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

NENI 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë , duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqsojnë shoqërinë tregtare
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi ne kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) kryen rregjistrimet dhe dërgonë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
- g) raportojmë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vacant për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut
- i) Administratori do te jete personi i vetem qe autorizon transaksionet bankare ne llogarite e shoqërisë

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që akivet e shoqërisë nuk e mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim
- shoqëria propozon të shes apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lart se 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara

- shoqëria brenda 2 (dy) viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë së 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbërjen e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikëruisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:
 - 1.a Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vemendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis
 - 1.b Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita
 - 1.c Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendimi
 - 1.ç Të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personal me ata të shoqërisë
 - 1.d Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 të këtij NENI, është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga

kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloj cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar me to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtime me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

4.a u kthen ortakeve kontributet

4.b u paguan ortakëve interest apo dividendët

4.c u shpërndan aktivet shoqërisë

4.ç lejonë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet

4.d jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimet financiare, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 16 Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierjen e

rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e t'ja dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

NENI 18

Fitimet

- Fitimet që rezultojnë nga bilanci duke zbritur 5% (pese perqind) për rezerva ligjore deri në arritjen 10% (dhjete perqind) të kapitalit si dhe shumat e tjera që mund të lenë menjane Asambleja me vendim, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar të zoteruara.
- Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpendaries së Fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet e tjera financiare.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 19

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaronë kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të Asambles së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të NENIt 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Tregtare të Biznesit”
- e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxier prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqërinë në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rastëve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi e emëruar nga Ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 20

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dispozitat e legjislacionit shqipëtarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregatre”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqipëtare.

ORTAKU I VETËM
